

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 96, datë 28.05.2026**

**PËR  
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE  
KRYETARIT TË BORDIT TË DREJTORËVE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 17, 20, 21 dhe 25, të ligjit nr. 52/2014 “Për sigurimin dhe risigurimin”, rregullores nr.137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Klaidi Çitozi si Drejtor i Përgjithshëm dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë së Sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., për një afat 3 vjeçar, deri në datë 20.06.2029.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Adela XHEMALI**